



Datë: 23.07.2025
Numër Protokolli: 5022/2025

A.nr.1071/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Malore Gashi-Bajraktari, anëtare, me Sabile Avdyli, në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1071/2025 të datës 04.06.2025 të parashtruar nga ankuesi B.M, kundër Komunës së Prizrenit, në çështjen juridike “kontestim konkursi” duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L180, si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 23.07.2025, mori këtë:

V E N D I M

Hidhet poshtë si e jashtë afatëshme ankesa me numër A.nr.1071/2025 e datës 04.06.2025, e parashtruar nga ankuesi B.M.

A r s y e t i m

Ankuesi, B.M (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), më datë 04.06.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është regjistruar nën shenjën A.nr.1071/2025, me pretendimet ankimore lidhur me refuzimin e aplikacionit në fazën e verifikimit paraprak.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 10.06.25 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Prizrenit ndërsa, kjo e fundit, më datë 19.06.2025, ka përcjellë përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritorë administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 3772/2025 të datës 04.06.2025, të parashtruar nga ankuesi në Këshill; Konkursin RN00016865 të datës 10.03.2025, Përgjigjen e datë 19.06.2025, Njoftimin e datës 23.04.2025 për dështimin e procedurës sipas konkursit RN00016865; Aplikacionin për B.M.

Kolegji i Këshillit ju referua nenit 27, paragrafi 3 dhe 4 Ligjit nr. 08/l-197 për Zyrtarët Publik, ku përcaktohet shprehimisht se; 3. *Nëpunësja/i civil ka të drejtë të paraqes ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto që burojnë nga marrëdhënia e punës në shërbimin civil*, 4. *E drejta e ankimit në KPMSHCK i njihet edhe çdo kandidateje/i në procedurë pranimi në shërbimin civil.*

si dhe nenin 127, paragrafi 1 me të cilin është përcaktuar se: “1. *Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ...*” rrjedhimisht në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe duke marrë parasysh faktin se ankuesi me datën 23.04.2025 e ka pranuar njoftimin për refuzimin e aplikacionit, të cilin e pranon edhe ankuesi në ankesën e paraqitur në KPMSHCK, ndërsa ankesën në KPMSHC e ka parashtruar me datë 04.06. 2025 e që është jashtë afatit të paraparë ligjore të përcaktuar me dispozitat e nenit 127 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Andaj, në këtë kuptim, Kolegji i Këshillit konstaton se ankesa e parashtruar jashtë afatit ligjor nuk është e pranueshme në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 ndërlidhur me nenin 127 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kështu që, thënë si me sipër dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1071/2025

Sabile Avdyli

Procesmbajtëse

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit B.M;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Prizrenit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.